

SHOQATA E KONTABILISTËVE DHE FINANCIERËVE TË SHQIPËRISË

RREGULLORE E REGJISTRIT TË KONTABILISTËVE TË MIRATUAR DHE SHOQËRIVE TË KONTABILITETIT TË SH.K.F.SH.

Funksioni propozues	Këshilli Drejtues
Funksioni aprovues	Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve
Data e aprovimit	24.10.2020

I. HYRJE

1. **Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë** (në vijim “SH.K.F.SH.” ose “Shoqata”) mban Regjistrin e Kontabilistëve të Miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit të anëtarësuar në Shoqatë (në vijim “Regjistri Publik”), në përputhje me këtë rregullore dhe parashikimet e aplikueshme ligjore e rregullatore të Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe me udhëzimet e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.
2. Kjo rregullore synon të krijojë një sistem efikas për regjistrimin e anëtarëve dhe regjistrimin e kontabilistëve të miratuar (aktivë e jo-aktivë) dhe shoqërive të kontabilitetit anëtare dhe për pasqyrimin/përditësimin e të dhënave të nevojshme në Regjistrin e Publik të Kontabilistëve të Miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit të anëtarësuar në Shoqatë.
3. Ky akt i brendshëm dhe i detyrueshëm për të gjithë anëtarët e SH.K.F.SH. është hartuar bazuar në nenin 51 dhe nenin 53 të Ligjit Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të kontabilistit të miratuar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar (në vijim “**Ligji Për Auditimin**”), Rregulloren Nr.9, datë 27.02.2019, “Për rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të profesionit të kontabilistit të miratuar dhe organizatave të tyre profesionale” të Bordit të Mbikëqyrjes Publike (në vijim “**Rregullore nr. 9**”), dhe nenin 28 dhe 29 të Statutit të Shoqatës.
4. Kjo Rregullore miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, në përputhje me rregullat e parashikuara në Statutin e SH.K.F.SH..
5. Termat në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuprim me ato të parashikuara në Statutin e Shoqatës dhe Ligjin Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Kontabilistit të miratuar dhe të Kontabilistit të miratuar”.

II. OBJEKTI I RREGULLORES

1. Kjo rregullore ka për qëllim:

- a) Zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregullatore për regjistrimin e anëtarëve kontabilistë të miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit në Regjistrin Publik të mbajtur nga Shoqata.
- b) Përcaktimin e procedurave dhe mënyrave të regjistrimit dhe të çregjistrimit nga Regjistri Publik i Kontabilistëve të Miratuar dhe të shoqërive të kontabilitetit, vendase dhe të huaja, të anëtarësuar në Shoqatë.

- c) Përcaktimin e rregullave dhe procedurave brenda SH.K.F.SH. për pasqyrimin e ndryshimeve në Regjistrin Publik dhe përditësimin e tij.
- d) Vendosjen e rregullave dhe procedurave për të garantuar të drejtat e anëtarëve për t'u regjistruar dhe çregjistruar nga Regjistri Publik;
- e) Vendosjen e rregullave, procedurave të formimit, organizimit dhe funksionimit të Komitetit të Regjistrimit të SH.K.F.SH. dhe përgjegjësitë e anëtarëve të këtij Komiteti.

III. KOMITETI I REGJISTRIMIT

1. Krijimi dhe përbërja e Komitetit të Regjistrimit

- 1.1 Shoqata krijon Komitetin e Regjistrimit si strukturë e posaçme që merret me procedurat e përditësimit të të dhënave, të regjistrimit dhe çregjistrimit në Regjistrin Publik të Kontabilistëve të Miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit të mbajtur nga SH.K.F.SH. Ai krijohet në zbatim të nenit 53 të Ligjit për Auditimin.
- 1.2 Komiteti i Regjistrimit përbëhet nga katër anëtarë të Shoqatës të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues i Shoqatës për një periudhë trevjeçare. Këshilli Drejtues emëron si Kryetar të Komitetit njërin nga anëtarët. Një nga anëtarët e Komitetit të Regjistrimit, me përjashtim të Kryetarit, mund të jetë gjithashtu anëtar i Këshillit Drejtues.
- 1.3 Kryetari i Komitetit të Regjistrimit dhe anëtarët e tjerë nuk duhet të mbajnë funksione ekzekutive apo të jenë anëtarë në Komitete apo Komisione të tjera të Shoqatës apo të shoqatave të tjera të ngjashme.
- 1.4 Komiteti i Regjistrimit është strukturë në varësi të Këshillit Drejtues të SH.K.F.SH., që vepron në përputhje me parashikimet në këtë rregullore.

2. Përgjegjësitë e Komitetit të Regjistrimit

- 2.1 Komiteti i Regjistrimit është përgjegjës për:
 - a) zbatimin e procedurave të regjistrimit në Regjistrin Publik të KM-ve dhe shoqërive të kontabilitetit anëtare të Shoqatës;
 - b) mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit publik të kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit, të mbajtur nga SH.K.F.SH.

- c) shqyrtimin e kërkesave të anëtarëve për t'u regjistruar, pezulluar ose çregjistruar nga Regjistri Publik;
- d) identifikimin e kontabilistëve të miratuar dhe të shoqërisë së kontabilitetit në Regjistrin Publik, me një numër individual;
- e) regjistrimin e kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit në përputhje me këtë rregullore dhe aktet ligjore dhe nënligjore të aplikueshme, duke shqyrtuar rastet me objektivitet dhe pa u ndikuar nga palë të treta në shqyrtimin e rasteve sipas kësaj rregulloreje; dhe
- f) përmbushjen e detyrave të tjera të parashikuara në këtë rregullore.

3. Funksionimi i Komitetit të Regjistrimit

- 3.1 Komiteti i Regjistrimit mbledhet çdo dy muaj në javën e parë të muajit pasardhës, në datën e njoftuar nga Kryetari, dhe sa herë kërkohet nga Kryetari i Komitetit të Regjistrimit.
- 3.2 Mbledhjet drejtohen nga Kryetari i Komitetit dhe në mungesë të këtij, mbledhjet drejtohen nga njëri prej anëtarëve të Komitetit.
- 3.3 Mbledhjet janë të vlefshme nëse të pranishëm janë më shumë se gjysma e anëtarëve të Komitetit të Regjistrimit, të cilët marrin vendime sipas pikës 4 të këtij Seksioni III.
- 3.4 Në mbledhjet e Komitetit shqyrtohen kërkesat për regjistrim/çregjistrim nga Regjistri Publik dhe dokumentacionin dhe materialet përkatëse të lidhura me kërkesat e paraqitura nga aplikuesit, Këshilli Drejtues ose/dhe BMP për regjistrim/çregjistrim në Regjistrin Publik pranë Shoqatës. Në mbledhjet e Komitetit shqyrtohen gjithashtu rastet për pasqyrimin e ndryshimeve në regjister në përputhje me Seksionin V, pika 2.
- 3.5 Për mbledhjet që mbahen me kërkesë të Kryetarit të Komitetit, anëtarët e Komitetit njoftohen nga sekretaria e Shoqatës, jo më vonë se pesë ditë para datës së mbledhjes.
- 3.6 Njoftimi si në pikën 3.5 përmban datën, orën, rendin e ditës, si dhe relacionin përkatës.
- 3.7 Komiteti i Regjistrimit asistohet nga sekretaria e Shoqatës duke paraqitur kërkesë për suport dhe ndihmë teknike, si dhe materiale pranë Drejtorit Ekzekutiv të Shoqatës.

- 3.8 Kryetari i Komitetit të Regjistrimit mban kontakte dhe komunikim të vazhdueshëm me Këshillin Drejtues dhe Drejtorin Ekzekutiv, duke u informuar për çdo kërkesë të paraqitur pranë saj.

4. Vendimet e Komitetit të Regjistrimit

- 4.1 Komiteti merr vendim për rastet e parashikuara në pikën 3.4 të këtij Seksioni me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
- 4.2 Vendimi shoqërohet nga një procesverbal, që përmban një përmbledhje të diskutimeve në mbledhje, dokumentet dhe materialet e shqyrtuara, dhe vendimin e Komitetit për rastin/et. Vendimi dhe procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje.
- 4.3 Vendimet kundër duhet të jenë të argumentuara në procesverbal. Vendimet, procesverbalet e mbledhjeve dhe dokumentacioni i detyrueshëm i paraqitur nga aplikuesit depozitohen në selinë e Shoqatës nën kujdesin e Drejtorit Ekzekutiv dhe ruhen për një periudhë pesëvjeçare.
- 4.4 Çdo vendim i Komitetit të Regjistrimit i njoftohet aplikuesit brenda 10 ditëve nëpërmjet sekretarisë së Shoqatës. Vendimet e lidhura pasqyrohen në Regjistrin Publik.
- 4.5 Vendimet e Komitetit të Regjistrimit për rrëzimin e kërkesave për t'u regjistruar në Regjistrin Publik duhet të jenë të arsyetuara dhe të përmbajnë referencat ligjore dhe rregullatore, të cilat nuk përmbushen nga kërkuesi/aplikuesi.
- 4.6 Vendimet e Komitetit të Regjistrimit mund të apelojnë nga aplikuesi pranë Këshillit Drejtues dhe/ose Bordit të Mbikëqyrjes Publike në përputhje me parashikimet e Seksionit VII të kësaj rregulloreje.

5. Lirimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Komitetit të Regjistrimit

- 5.1 Anëtari i Komitetit të Regjistrimit lirohet nga detyra në rastet kur:
- a) mbaron mandati;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) çregjistrohet nga Regjistri Publik ose ka pezulluar përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë si kontabilist i miratuar;

5.2 Këshilli Drejtues i SH.K.F.SH. ka të drejtë të shkarkojë një anëtar të Komitetit të Regjistrimit, kur:

- a) nuk merr pjesë, pa arsye, në mbledhjet e Komitetit të Regjistrimit për më shumë se katër herë radhazi;
- b) veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e SH.K.F.SH.;
- c) nuk përmbush funksionet e parashikuara nga ligji dhe kjo rregullore;
- d) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- e) për shkaqe sëmundjesh fizike ose mendore, gjë që i bën të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;
- f) për shkelje të kuadrit rregullator në fuqi.

5.3 Këshilli Drejtues, në rastet kur anëtari i Komitetit të Regjistrimit lirohet, shkarkohet, dorëhiqet apo vdes, duhet të caktojë një zëvendësues, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh pune, duke filluar nga data e njoftimit të lirimit, shkarkimit, dorëheqjes apo vdekjes, në përputhje me procedurat e përzgjedhjes.

5.4 Mandati (trevjeçar) i zëvendësuesit llogaritet nga dita e emërimit të tij nga Këshilli Drejtues sipas pikës 5.3 më sipër.

6. Shpërblimi i anëtarëve të Komitetit të Regjistrimit

6.1 Anëtarët e Komitetit të Regjistrimit kanë të drejtën e shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve në masën e përcaktuar nga Këshilli Drejtues.

6.2 Masa e shpërblimit mund të ndryshojë në varësi të rasteve të shqyrtuara. Shpërblimi i Kryetarit të Komitetit të Regjistrimit është më i lartë se ai i anëtarit të këtij Komiteti.

7. Shqyrtimi i kërkesave

7.1 Gjatë shqyrtimit të rasteve të paraqitura për regjistrim/çregjistrim, Komiteti i Regjistrimit udhëhiqet nga parimi i pjesëmarrjes së aplikuesit/kërkuesit, nëpërmjet vënies në dijeni, dëgjimit dhe verifikimit të rastit dhe të trajtimit të tij në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë.

- 7.2 Kur e gjykon të nevojshme, Komiteti i Regjistrimit organizon seanca dëgjimore të aplikuesit, që ka paraqitur kërkesën për regjistrim/çregjistrim, duke e njoftuar atë për vendin dhe kohën e zhvillimit të seancës dëgjimore.
- 7.3 Secili prej anëtarëve të Komitetit të Regjistrimit, kur gjykon se procedurat e ndjekura lidhur me funksionet dhe vendimmarrjen e Komitetit nuk janë zbatuar në pajtueshmëri me këtë rregullore apo me legjislacionin në fuqi, vë në dijeni Këshillin Drejtues të Shoqatës, i cili, kur e shikon të përshtatshme, njofton BMP lidhur me parregullsitë e procesit.

8. Detyrimi për njoftimin e BMP për ndryshimet në Regjistër

- 8.1 Komiteti i Regjistrimit sigurohet për transferimin e informacionit të detyrueshëm, brenda afateve ligjore, pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike me qëllim azhurnimin e regjistrit të konsoliduar të kontabilistëve të miratuar, që publikohet në faqen zyrtare të BMP.

IV. PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË KONTABILISTËVE TË MIRATUAR DHE SHOQËRIVE TË KONTABILITETIT

1. Regjistrimi i kandidatëve

- 1.1 Pas përfundimit të provimeve të aftësisë profesionale, kandidatët për kontabilistë të miratuar aplikojnë për regjistrim dhe dorëzojnë pranë sekretarisë së Shoqatës dokumentacionin e lëshuar, në pajtueshmëri me kuadrin rregullator të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, që tregon përfundimin me sukses të provimit të aftësive profesionale.
- 1.2 Pasi dorëzohen evidencat e përfundimit me sukses të provimit të aftësive profesionale dhe i gjithë dokumentacioni për regjistrim në Regjistër, që parashikon kjo Rregullore, nga ana e aplikuesit, Komiteti i Regjistrimit e regjistron në Regjistër dhe e pajis kontabilistin e miratuar me një numër individual unik.
- 1.3 SH.K.F.SH, pas regjistrimit të kandidatit si kontabilist i miratuar në Regjistër nga Komiteti i Regjistrimit, lëshon licencën profesionale, në të cilën shënohet numri unik i kontabilistit të miratuar.
- 1.4 Ushtrimi i profesionit nga kontabilisti i miratuar, anëtar i Shoqatës, në praktikë, kryhet vetëm pas regjistrimit të këtij në Regjistrin Publik.

2. Regjistrimi i kontabilistëve të miratuar në Regjistrin Publik

- 2.1 Regjistrimi është procesi i përfshirjes së kontabilistëve të miratuar vendas dhe të huaj, si dhe i shoqërive të kontabilitetit, vendase dhe të huaja, në Regjistrin Publik të kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit, të mbajtur nga SH.K.F.SH..
- 2.2 Të drejtën për t'u regjistruar në Regjistrin Publik e kanë të gjithë personat fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 10091/2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të kontabilistit të miratuar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, dhe që parashikohen e referohen në këtë rregullore.
- 2.3 Kërkesa e aplikuesit për regjistrim i adresohet, me shkrim, Komitetit të Regjistrimit, përmes sekretarisë së Shoqatës.
- 2.4 Kërkesa nënshkruhet nga aplikuesi dhe duhet të shoqërohet me:
 - a) dokumentin që tregon për përfundimin me sukses të provimeve të aftësisë profesionale,
 - b) deklaratën e lëshuar në përgjegjësinë personale të aplikuesit, për dhënien fund të papajtueshmërive që kërkohen për ushtrimin e profesionit në praktikë
 - c) deklaratën e lëshuar në përgjegjësinë personale të aplikuesit për garancitë etike e morale.
- 2.5 Kontabilistët e miratuar në bazë të vendimit të Komitetit të Regjistrimit përfshihen në Regjistrin Publik. Vetëm pas kësaj përfshirjeje, ata kanë të drejtë të kryejnë veprimtarinë dhe të japin shërbime kontabiliteti apo shërbime të lidhura, kur ato nuk bien ndesh me kërkesat e parashikuara në këtë ligj, me standardet profesionale dhe me Kodin e Etikës të Shoqatës.

3. Regjistrimi i shoqërive të kontabilitetit

- 3.1 Komitetit i Regjistrimit regjistron një shoqëri kontabiliteti për dhënien e shërbimeve të kontabilitetit, tregtarëve dhe shoqërive tregtare që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, në qoftë se shoqëria e kontabilitetit plotëson kushtet e mëposhtme:
 - a) është themeluar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe sipas kërkesave të Ligjit Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe për shoqëritë e huaja në përputhje me legjislacionin tatimor;
 - b) shumica e të drejtave të votës në kapitalin e shoqërisë zotërohen nga shoqëri kontabiliteti, nga kontabilistë të miratuar ose nga shoqëri kontabiliteti dhe kontabilistë të miratuar.
 - c) shumica e anëtarëve të organit drejtues ose administrativ të shoqërisë së kontabilitetit janë kontabilistë të miratuar, vendas ose të huaj, të njohur nga Komiteti i Regjistrimit dhe

të regjistruar në Regjistrin Publik të Kontabilistëve të Miratuar. Kur organi drejtues ose administrativ nuk ka më shumë se dy anëtarë, të paktën njëri prej këtyre anëtarëve duhet të plotësojë kushtet e përmendura në këtë shkronjë;

- d) shoqëria angazhon kontabilistë të miratuar, vendas ose të huaj, të cilët janë të regjistruar në Regjistrin Publik të Kontabilistëve të Miratuar;
- e) shoqëria gëzon reputacion të mirë (personat e angazhuar me drejtimin e shoqërisë apo të punësuarit plotësojnë kushtet sipas dokumentacionit të parashikuar pikën 4.1 të këtij Seksioni, në lidhje me vërtetimin për gjendjen gjyqësore, dëshminë e penalitetit dhe vërtetimin se ndaj tyre nuk ka pasur masa të mëparshme disiplinore).

4. Dokumentet që kërkohen për regjistrimin e kontabilistëve të miratuar

4.1 Për t'u regjistruar në Regjistrin Publik, kontabilisti i miratuar i drejtohet me shkrim Komitetit të Regjistrimit të SH.K.F.SH. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin që vijon:

a) Për kontabilistin e miratuar, shtetas shqiptar:

- (i) Kërkesa e aplikuesit drejtuar Komitetit të Regjistrimit, e nënshkruar prej tij;
- (ii) Curriculum Vitae;
- (iii) Dokument identifikimi i vlefshëm;
- (iv) Vërtetim nga prokuroria e rrethit se ndaj shtetasit nuk është filluar hetim për çështje penale;
- (v) Vërtetim nga gjykata e rrethit se kërkuesi nuk është në proces gjyqësor;
- (vi) Certifikatë e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti), që tregon se aplikuesi nuk është i dënuar për vepra penale;
- (vii) Deklaratë për dhënien fund të papajtueshmërive që kërkohen për ushtrimin e profesionit;
- (viii) Kopje e njehsuar e certifikatës së titullit Kontabilist i Miratuar ose vërtetimin për përfundimin me sukses të provimeve të aftësive profesionale.
- (ix) Vërtetim nga organizata profesionale e kontabilistëve të miratuar ose nga institucionet dhe subjektet e tjera të parashikuara me ligj për pjesëmarrjen në

kualifikimin e vijueshëm profesional për kohën që nuk ka ushtruar profesionin e kontabilistit të miratuar (nëse është e përshtatshme);

- (x) Vërtetim nga organizata profesionale e kontabilistëve të miratuar për shlyerjen e detyrimeve financiare, lidhur me kuotat e anëtarësisë dhe detyrime të tjera të aplikueshme;
- (xi) Certifikatën e regjistrimit në QKB dhe kopje të Ekstraktit të QKB;

4.2 Në rastet kur në momentin e aplikimit nuk zotërohet dëshmia e penalitetit dhe vërtetimi i gjendjes gjyqësore, aplikuesi dorëzon një vetëdeklarim mbi gjendjen gjyqësore deri në dorëzimin e dokumenteve të përcaktuara në këtë pikë.

5. Dokumentacioni për regjistrimin e kontabilistit të miratuar, shtetas i huaj

5.1 Për t'u regjistruar në Regjistrin Publik, kontabilistit të miratuar i duhet të paraqesë:

- (i) kopje të noterizuar të kërkesës për dhënien e provimit të aftësive profesionale pranë Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale;
- (ii) dokumentacionin e nevojshëm, që tregon për titullin 'kontabilist i miratuar' të marrë në një shtet tjetër. Dokumentacioni duhet të jetë në origjinal ose i noterizuar dhe i përkthyer në gjuhën shqipe dhe vërtetuar nga noteri publik.

5.2 Komiteti i Regjistrimit sigurohet që përmbajtja e dokumentacionit, që paraqitet për regjistrimin e kontabilistit të miratuar të huaj dhe të shoqërive të huaja të kontabilitetit në Regjistrin Publik të kontabilistëve të miratuar, të jetë në përputhje me përcaktimet e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

5.3 Këshilli Drejtues bën vlerësimin e pajtueshmërisë së kushteve të përgatitjes së kontabilistëve të miratuar të huaj me kushtet e përgatitjes së kontabilistëve të miratuar vendas dhe i dërgon një raport Komitetit të Regjistrimit.

5.4 Përveç sa më sipër, kontabilisti i miratuar, shtetas i huaj, për t'u regjistruar paraqet:

- (i) Dëshmi të penalitetit të nxjerrë brenda 6-mujorit të fundit nga shteti ku ka rezidencën e përhershme të apostiluar. Dëshmia përkthehet në gjuhën shqipe dhe vërtetohet përkthimi nga një noter publik shqiptar.

- (ii) Mbajtësit e titullit kontabilist i miratuar të një shteti tjetër duhet të dorëzojnë edhe certifikatën ose vërtetimin e organizatës profesionale për njohjen e titullit.

6. Regjistrimi i shoqërive të kontabilitetit në Regjistrin Publik

6.1 Për t'u regjistruar në Regjistrin Publik, një shoqëri kontabiliteti që vepron në Republikën e Shqipërisë duhet të plotësojë kushtet e parashikuara më poshtë:

- a. është regjistruar sipas kërkesave të ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- b. shumica e të drejtave të votës në kapitalin e shoqërisë zotërohen nga shoqëri kontabiliteti, vendase ose të huaja, nga kontabilistë të miratuar ose nga shoqëri kontabiliteti dhe kontabilistë të miratuar të regjistruar në Regjistrin Publik të Shoqatës ose të organizatave të tjera profesionale të kontabilitetit;
- c. shumica e anëtarëve të organit drejtues ose administrativ të shoqërisë janë kontabilistë të miratuar, vendas ose të huaj, të regjistruar në Regjistrin Publik të kontabilistëve të miratuar;
- d. kur organi drejtues ose administrativ nuk ka më shumë se dy anëtarë, të paktën njëri prej këtyre anëtarëve duhet të plotësojë kushtet e përmendura në këtë shkronjë;
- e. shoqëria angazhon kontabilistë të miratuar, vendas ose të huaj, të cilët janë të regjistruar në një Regjistrin Publik të kontabilistëve të miratuar;
- f. shoqëria gëzon reputacion të mirë.

6.2 Kërkesa për regjistrim të shoqërisë në Regjistrin Publik bëhet nga administratori i shoqërisë, i cili duhet të jetë i regjistruar si kontabilist të miratuar dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Për shoqëritë e kontabilitetit:

- (i) Vendimi i asamblesë së partnerëve/ortakëve/aksionerëve për regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Publik të Kontabilistëve të Miratuar;
- (ii) Certifikatën e regjistrimit në QKB
- (iii) Ekstrakt historik i freskët i shoqërisë, lëshuar nga QKB;

- (iv) Statuti i shoqërisë;
- (v) Listën e kontabilistëve të miratuar të shoqërisë, përfshirë dhe administratorin, të cilët plotësojnë kushtet për të ushtruar profesionin e kontabilistit të miratuar dhe nuk janë ushtrues të profesionit si person fizik;
- (vi) Në rastin e individëve ortakë të shoqërisë së kontabilitetit, të cilët nuk janë kontabilistë të miratuar, duhet të paraqitet dokumentacioni dhe të dokumentohet në dosjen e regjistrimit të shoqërisë së kontabilitetit:
 - Dokument identifikimi biometrik i vlefshëm;
 - Vërtetim nga prokuroria e rrethit se ndaj shtetasit nuk është filluar çështje penale; vërtetim nga gjykata e rrethit se kërkuesi nuk është në proces gjyqësor;
 - Certifikatë e gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti), që tregon se individit nuk është i dënuar;

6.3 Në rastin kur zotërues i kuotave/aksioneve/pronësisë së kapitalit është një person juridik (shoqëri jokontabiliteti), në dosjen e shoqërisë së kontabilitetit do të dokumentohen të dhënat për të gjithë pronarët (individë) e fundit përfitues të personit juridik, personat pjesë e organeve të drejtimit apo që kanë kontroll të cilësuar, duke paraqitur për pronarët e fundit përfitues dokumentet e listuara në pikën (vi) më sipër.

6.3 Dokumentacioni i përmendur më sipër në këtë pikë 6, në çdo rast, duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe në përputhje me kërkesat ligjore të Republikës së Shqipërisë (original ose i noterizuar).

7 Kostot e regjistrimit

7.1 Shpenzimet e regjistrimit në Regjistrin Publik mbulohen nga aplikuesi. Këshilli Drejtues me vendim përcakton tarifat sipas natyrës së shërbimit dhe ia propozon Bordit të Mbikëqyrjes Publike për t'i miratuar.

V. REGJISTRI PUBLIK I SHOQATËS

1. Regjistri Publik i SH.K.F.SH.

1.1 Regjistri mbahet në format elektronik dhe është i hapur për publikun dhe personat e interesuar. Regjistri Publik publikohet në faqen zyrtare të Shoqatës.

1.2 Komiteti i Regjistrimit është struktura përgjegjëse që siguron:

- a) mbajtjen dhe përditësimin e Regjistrit Publik të Kontabilistëve të Miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit;
- b) identifikimin e kontabilistit të miratuar dhe të shoqërisë së kontabilitetit në Regjistrin Publik, me një numër individual;
- c) publikimin në Regjistër të të gjithë anëtarëve jo-aktivë (kontabilistit të miratuar të tërhequr përkohësisht apo që nuk e ushtrojnë profesionin).

1.2 Formati i Regjistrit Publik të Kontabilistëve të Miratuar miratohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike dhe përmban një seksion për kontabilistët e miratuar dhe një seksion për shoqëritë e kontabilitetit. Seksioni i kontabilistëve të miratuar parashikon/ndahet në kontabilistë të miratuar aktivë dhe jo-aktivë.

1.3 Informacioni për regjistrimin mbahet në format elektronik dhe vihet në dispozicion të publikut nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të SH.K.F.SH.

1.4 Regjistri Publik në format elektronik publikohet në faqen zyrtare të internetit të SH.K.F.SH. në gjuhën shqipe, sipas formatit të miratuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

1.5 Komiteti i Regjistrimit publikon, në një aneks të veçantë të Regjistrit Publik, të gjithë individët kontabilistë të miratuar që kanë mbushur moshën 65 vjeç. Këta individë mund ta ushtrojnë profesionin e kontabilistit të miratuar vetëm nëse janë të punësuar ose të angazhuar në një shoqëri kontabiliteti, të regjistruar në Regjistër Publik të Kontabilistëve të Miratuar.

1.6 Regjistri Publik mund të mbahet edhe në formë dokumenti për nevoja të Shoqatës.

1.7 Të dhënat e Regjistrit i vihen në dispozicion Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe/ose institucioneve të tjera, në përputhje me legjislacionin e përkatës nën kujdesin e Drejtorit Ekzekutiv të Shoqatës.

2. Përditësimi i Regjistrit Publik

2.1 Kontabilisti i miratuar apo shoqëria e kontabilitetit e regjistruar në Regjistrin Publik, njofton Komitetin e Regjistrimit për ndryshimet e informacioneve të detyrueshme për publikim.

2.2 Në raste të ndryshimit të administratorëve apo kuotave/aksioneve, për shoqëritë e kontabilitetit, njoftimi shoqërohet me kopje të ekstraktit të QKB, kontratën e shitblerjes së

aksioneve/të pjesëve, si dhe çdo dokument tjetër, që gjykohet i nevojshëm nga Komiteti i Regjistrimit.

- 2.3 Komiteti i Regjistrimit, me marrjen e njoftimit dhe pasi verifikon plotësimin e kushteve të parashikuara ligjore e rregullatore dhe kushteve në këtë rregullore, brenda një periudhe 10-ditore (kalendarike), kryen përditësimin e informacionit të Regjistrat Publik në faqen zyrtare të internetit të Shoqatës.
- 2.4 Komiteti i Regjistrimit, kur vihet në dijeni të vendimit të marrë për masë disiplinore që lidhet me shënime në regjistër brenda një periudhe 10-ditore, kryen përditësimin e informacionit të Regjistrat Publik në faqen zyrtare të internetit.
- 2.5 Në rastet kur shkelen kushtet dhe/ose kur ndryshojnë rrethanat e parashikuara në këtë rregullore, të cilat konsiderohen të domosdoshme për regjistrimin e një kontabilisti i miratuar apo shoqërie kontabiliteti, Komiteti i Regjistrimit vë në dijeni Këshillin Drejtues, i cili, pasi vlerëson rastin, vë në dijeni Bordin e Mbikëqyrjes Publike dhe/ose Komisionin Disiplinor të Shoqatës për shqyrtimin e rastit.

3. Pezullimi i veprimtarisë së kontabilistit të miratuar dhe reflektimet në regjistër

- 3.1 Kontabilisti i miratuar, me një kërkesë për pezullimin e ushtrimit të veprimtarisë, mund të kërkojë të tërhiqet përkohësisht nga ushtrimi i profesionit.
- 3.2 Kërkesa për pezullim i drejtohet me shkrim Komitetit të Regjistrimit, përmes sekretarisë së Shoqatës. Ajo duhet të jetë e motivuar dhe të tregojë veprimtarinë e re që do të ndërmerret i interesuari, si dhe periudhën për të cilën kërkohet pezullimi apo, kur kjo periudhë nuk mund të identifikohet, datën në të cilën kërkohet të fillojë pezullimi.
- 3.3 Komiteti i Regjistrimit e shqyrton kërkesën në mbledhjen e tij më të parë dhe nëse çmon se veprimtaria e tij e re nuk është e natyrës që u sjell dëm interesave etikë e moralë të profesionit, e miraton kërkesën dhe vendos fshirjen e përkohshme të të interesuarit nga Regjistri Publik.
- 3.4 Miratimi në pikën 3.3 pasqyrohet në vendimin përkatës të Komitetit të Regjistrimit, i cili merr masat për ndryshimet e nevojshme në Regjistrin Publik të publikuar në faqen zyrtare të Shoqatës, të cilat pasqyrohen në faqen zyrtare jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga marrja e vendimit.
- 3.5 Në rastet kur Komiteti i Regjistrimit konstaton parregullsi të mundshme në dokumentet dhe faktet e deklaruar gjatë procedurave të pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të profesionit, Komiteti informon Komisionin Disiplinor dhe vë në dijeni Këshillin Drejtues të Shoqatës.

- 3.6 Kontabilisti i miratuar, i cili për një periudhë të caktuar kohe ka pezulluar veprimtarinë si kontabilist i miratuar, ka të drejtë të rinisë atë duke shlyer kuotat e anëtarësisë dhe çdo detyrim tjetër sipas pikës 9 të këtij Seksioni, të cilat verifikohen nga Komiteti i Regjistrimit, i cili merr vendim për reregjistrimin dhe pasqyrimin në Regjistër.
- 3.7 Në rastet kur kontabilisti i miratuar ka rinisur veprimtarinë përpara marrjes së vendimit nga Komiteti i Regjistrimit dhe ky i fundit vëren, gjatë shqyrtimit, se veprimtaria e tij e re është e natyrës, që u sjell dëm interesave etikë e moralë të profesionit, vendos çregjistrimin e kontabilistit të miratuar nga Regjistri Publik i Kontabilistëve të Miratuar. Përcaktimi i veprimeve që u sjell dëm interesave etikë e moralë të profesionit bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në rregulloren nr. 4, datë 29.03.2018 të miratuar nga BMP dhe Rregulloren e Shoqatës “Për investigimin dhe masat disiplinore”, të miratuar nga BMP.
- 3.8 Nga data e njoftimit të vendimit, që shpall fshirjen e përkohshme nga Regjistri Publik, kërkuesi nuk mund të ushtrojë në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e vet profesionin e kontabilistit të miratuar dhe as ta përdorë këtë titull për shërbime të përcaktuara në ligj, angazhimi i të cilave është atribut i ushtruesve të profesionit, që janë pjesë e Regjistrat Publik të Kontabilistëve të Miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit.
- 4 Fshirja e përkohshme nga regjistri publik, me kërkesën e kontabilistit të miratuar, nuk ka efekt mbi procedurat disiplinore, të nisura për shkeljet e kryera prej tij përpara fshirjes.
- 5 Pezullimi i kontabilistit të miratuar mund të kryhet edhe në rastin kur ndaj tij është marrë masa disiplinore “Pezullim i përkohshëm” nga Komisioni i Disiplinor i Shoqatës dhe Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës i BMP.

6 Riregjistrimi në Regjistrin Publik të Kontabilistëve të Miratuar

- 6.1 Anëtari i tërhequr përkohësisht nga ushtrimi i profesionit (anëtar jo-aktiv) mund të kërkojë reregjistrimin e tij.
- 6.2 Riregjistrimi nga Komiteti i Regjistrimit bëhet nëse kontabilisti i miratuar ka përmbushur të gjitha detyrimet e kualifikimit të vijueshëm profesional edhe gjatë kohës kur ai nuk e ka ushtruar profesionin.
- 6.3 Kontabilisti i miratuar (aplikuesi) i adresohet Komitetit të Regjistrimit nëpërmjet sekretarisë dhe dorëzon dokumentet e mëposhtme:
- (i) Kërkesë për reregjistrim, drejtuar Komitetit të Regjistrimit, e nënshkruar prej tij dhe ku parashtron arsyet për kërkesën;

- (ii) Vërtetimin e një organizate profesionale e kontabilistëve të miratuar/apo institucioni edukimi i njohur/akredituar nga BMP, për kryerjen e kualifikimit të vijueshëm profesional, në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullatore për kryerjen e kualifikimit të vijueshëm profesional, për kohën që nuk ka ushtruar profesionin e kontabilistit të miratuar.
- (iii) Në rastin kur kurset e kualifikimit të vijueshëm kryhen pranë SH.K.F.SH., ato dorëzohen nga Shoqata drejtpërdrejt te Komiteti i Regjistrimit, pa pasur nevojë për lëshimin e një vërtetimi.
- (iv) Curriculum vitae;
- (v) Vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar rishtas nga autoriteti kompetent;
- (vi) Dëshmi penaliteti që tregon se aplikuesi nuk është i dënuar, lëshuar rishtas nga autoriteti kompetent;
- (vii) Deklaratë për dhënien fund të papajtueshmërive që kërkohen për ushtrimin e profesionit;
- (viii) Vërtetim e Shoqatës për shlyerjen e detyrimeve financiare, lidhur me kuotat e anëtarësisë dhe detyrime të tjera;
- (ix) Certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe kopje të ekstraktit të lëshuar nga QKB.

6.4 Në rastet kur në momentin e aplikimit nuk zotërohet dëshmia e penaltetit dhe vërtetimi i gjendjes gjyqësore, aplikuesi dorëzon një vetëdeklarim mbi gjendjen gjyqësore deri në dorëzimin e dokumenteve të përcaktuara në këtë pikë.

VI. ÇREGJISTRIMI I KONTABILISTËVE TË MIRATUAR NGA REGJISTRI PUBLIK DHE REVOKIMI I KARTËS PROFESIONALE

1. Revokimi i kartës profesionale

1.1 Kontabilistit të miratuar i revokohet karta profesionale dhe fshihet përfundimisht nga Regjistri Publik i Kontabilistëve të Miratuar të SH.K.F.SH. në rastet kur:

- a) heq dorë nga e drejta për ushtrimin e profesionit. Heqja dorë bëhet nëpërmjet deklaramit me shkrim, i cili paraqitet pranë Komitetit të Regjistrimit, kopje e të cilit i dërgohet dhe BMP-së, nëpërmjet Këshillit Drejtues;

- b) konstatohen parregullsi në:
 - i. dokumentet e nevojshme, të lidhura me provimet e aftësisë profesionale;
 - ii. deklarinimet, të cilat rezultojnë të pavërteta, në lidhje me dhënien fund të papajtueshmërive, që kërkohen për ushtrimin e profesionit në praktikë dhe për garancitë etike e morale, të dorëzuara në çastin e bërjes së kërkesës për regjistrimin e parë në Regjistrin Publik;
 - iii. dokumentet dhe në faktet e deklaruara gjatë procedurave të mundshme të pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të profesionit.
- c) në përfundim të një procedure disiplinore ndaj tij, është marrë masa disiplinore e çregjistrimit nga regjistri publik;
- d) për shkak të shkeljeve dhe masave disiplinore të përsëritura, reputacioni i të regjistruarit është cenuar ndjeshëm;
- e) në përputhje me dispozitat e ligjit dhe rregullatorëve të BMP, është vendosur çregjistrimin nga Regjistri Publik;
- f) parashikohet në ligj.

2. Fshirja e shoqërive nga Regjistri Publik

2.1 Shoqëria e kontabilitetit fshihet përfundimisht nga Regjistri Publik i Kontabilistëve të Miratuar i Shoqatës, në rastet kur:

- a) shoqëria çregjistrohet në QKB;
- b) kundër shoqërisë është hapur procedurë falimentimi dhe gjykata ka vendosur likuidimin e masës së falimentimit;
- c) përfundon afatin e ushtrimit të veprimtarisë së parashikuar në statutin e vet;
- d) e drejta për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri kontabiliteti hiqet nga Këshilli Drejtues i Shoqatës ose nga BMP.

- 2.2 Për secilin nga rastet e parashikuara në pikën 2.1, Komiteti i Regjistrimit merr masat për çregjistrimin e shoqërisë së kontabilitetit nga Regjistri Publik i Shoqatës dhe pasqyrimin e ndryshimit në Regjistrin Publik, të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Shoqatës.

VII. ANKIMIMI I VENDIMEVE TË KOMITETIT TË REGJISTRIMIT

1. Vendimet e Komitetit të Regjistrimit, sipas kësaj rregulloreje, mund të apelojnë nga subjekti i vendimit pranë Këshillit Drejtues brenda 15 ditësh kalendarike nga marrja e njoftimit për vendimin sipas pikës 4.4 të Seksionit III.
2. Apeli i vendimit të Komitetit të Regjistrimit nënshkruhet nga aplikuesi dhe përmban arsyet e qëndrimit kundër këtij vendimi, dhe shoqërohet nga dokumente mbështetëse.
3. Këshilli Drejtues mbledhet dhe merr vendim mbi rastin jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga dita e depozitimit të apelit në sekretarinë e Shoqatës.
4. Aplikuesi mund të apelojë vendimin e Komitetit të Regjistrimit dhe vendimin e Këshillit Drejtues (nëse apelohej pranë Këshillit), drejtpërdrejt pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike brenda 45 ditësh kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit sipas pikës 4.4 të Seksionit III.